

VENDIM
Nr. 303, datë 9.5.2012

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË TE
MINISTRIA E BRENDSHME TË OBJEKTIT “KARANTINA - DOGANË- HANI I HOTIT” DHE
PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
RENDIT PUBLIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja “c” të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Shëndetësisë te Ministria e Brendshme (për Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit), të objektit “Karantina-Doganë-Hani i Hotit”, Malësi e Madhe.

2. Listës së pronave, që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar, t’i shtohet prona sipas formularit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha